

Emri i komunës: **Komuna Dragash**



1. Adresa dhe Kontakti

- *Adresa e selisë së komunës:* Selia e Komunës është në Dragash dhe ndodhet në rrugën “Deshmorët e Kombit”.
- *Web-faqja zyrtare:* <http://kk.rks-gov.net/dragash/Home.aspx>
- *Telefoni dhe e-mail adresa për kontakt:* 029 /281- 543
- *Linku për komunikim në rrjetet sociale apo tjera:*

Misioni i komunës

Krijimi i një zone me bujqësi efikase, turizëm të zhvilluar, mjedis të pastër duke u bazuar në shfrytëzimin e drejtë të resurseve natyrore dhe tradicionale. Të gjitha grupet e shoqërisë do të jetojnë së bashku në kushte më të mira të jetesës.

2. Statistika

Popullsia	33,997
Struktura e popullsisë	
Shqiptar	20,287
Goran	8,957
Boshnjak	4,100
RAE	10
Të tjerë	621

Sipërfaqja	430 km ²
Vendbanime	36
Zona Urbane	1
Mosha mesatare	
GM: 0 - 19	11,705
GM: 20 - 64	19,153

3. Dita e komunës

- 15 Qershor – Dita e Çlirimit
- 4 Maj – Dita e Dëshmorëve

4. Përshkrimi i komunës

Historiku i komunës së Dragashit, daton nga periudha e lashtë që ende janë objekt gjurmimesh. Në këtë trevë historikisht jetoi popullata iliro-dardane, duke u pushtuar gradualisht nga Perandoria Romake. Pas shekullit të II-të para erës sonë, pastaj nën Perandorinë Bizantine e më vonë edhe nga perandoria Turke-Osmane e cila me monumente historiko-fetare la gjurmët e konfesionit islam të dy trevave - Opojës shqiptare dhe Gores me të folmen e saj karakteristike.

Në strukturat e pushtetit lokal janë të inkorporuara, bashkarisht e reciprokisht, përfaqësuesit e zgjedhur nga të dy trevat - Opoja dhe Gora, që do të thotë se kjo popullatë është e lidhur historikisht në mes veti dhe se tani është prezente liria e lëvizjes dhe mardhëniet e mira ndërfaqinësore në mes të pjesës dërmuese të popullatës së këtushme.

Komuna ka një histori politike si çdo komune tjetër në Republikën e Kosovës. Atë e kanë drejtuar subjekte të ndryshme politike në periudha të ndryshme kohore. Në zgjedhjen e fundit lokale 2013, me komunën e Dragashit udhëheq Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

5. Profili

Komuna e Dragashit përfshinë skajin jugor të rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me komunën e Prizrenit, në pjesën Jug-lindore dhe lindore, përmes majeve të larta të maleve të Sharrit, kufizohet me Maqedoninë. Ndërsa, nga Perëndimi dhe Jug-perëndimi me Shqipërinë. Territori i komunës së Dragashit shtrihet në një sipërfaqe prej 430 km² dhe zë afro 4 % të territorit të Kosovës. Komuna e Dragashit ka relief kodrinore-malor dhe në pjesët kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e ndajnë kurora të larta malore. Ndërsa, në drejtim të Shqipërisë edhe gryka të thella lumore, të pa përshtatshme për kalim. Në anën tjetër pjesa kodrinore me rrënjë më të butë, në drejtim të Prizrenit ofron kushte më të mira dhe ky territor lidhet përmes Prizrenit me Kosovën dhe më gjerë.

Karakteristikat klimatike - Klima prezente në komunën e Dragashit është klimë malore-kontinentale e ashpër, ku stina e dimrit është mjaftë e gjatë ndërsa ajo e verës e shkurtër. Klimë subalpine me temperaturë mesatare vjetore prej 8.6° Celsius. Vera të shkurta dhe të freskëta me temperaturë mesatare prej 18.1° C, me dimra të gjatë dhe relativisht të ftohtë (temperaturë mesatare -0.4°C).

Një pjesë e konsiderueshme e Komunës së Dragashit (24, 206.52 Ha) është shpallur pjesë e Parkut Nacional Sharri. Zona të mbrojtura në komunën e Dragashit janë: Namazgjahu, Mullinjtë dhe Tyrbet.

6. Zhvillimi Ekonomik dhe degët kryesore të ekonomisë lokale

Ekonomia e komunës së Dragashit deri vonë ka qenë e bazuar kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe industrisë së tekstilit për përpunimin e leshit përmes ndërmarrjeve shoqërore. Numri më i madh i të punësuarve ka qenë në këto lami. Degët kryesore ekonomike që karakterizojnë këtë pjesë të Kosovës janë: Bujqësia, Blegësia, industria e tekstilit, Ekoturizmi dhe Zejtaria.

Pozita gjeografike, klima, hidrografia, flora dhe fauna, si dhe trashëgimia kulturore janë pasuritë më të çmueshme të territorit të komunës së Dragashit, të cilat janë potencial permanent për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit: Turizmi rekreativ dhe sportiv dimëror, Turizmi malor dhe Turizmi transitor që konsiderohen madje sektori më i rëndësishëm ekonomik.

Njëherë, i është dhënë rëndësi e veçantë shfrytëzimit të vullqësor të rrjedhjeve të lumenjve për ngritjen e HE.

7. Planet dhe Strategjitë Komunale:

1. Plani zhvillimor komunal

Rregulloret e komunës:

REGJISTRI I RREGULLOREVE KOMUNALE

1. Rregullorja mbi tatimin në pronë për vitin 2016,
2. Rregullorja mbi lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave,
3. Rregullorja mbi tatimin në pronë për vitin 2015
5. Aneks rregullorja mbi lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave,
6. Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit,
7. Rregullorja për ndarjen e subvencioneve
8. Rregullorja e shkollave të mesme,
9. Rregullorja mbi përdorimin e vullqësor,
10. Rregullorja mbi ruajtjen e tokës bujqësore,
11. Rregullorja mbi përdorimin e gjuhëve,

12. Rregullorja për dhënien me qira të paluejtshmrisë komunale,
13. Rregullorja për leje pune,
14. Rregullorja për pjesëmarrje të qytetarëve në vendosje.
15. Rregullorja e punës së kuvendit,

19. Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi lartësinë e taksave,ngarkesave dhe gjobave,
20. Rregullorja për konsultim publik dhe pjesëmarrja e publikut në vendosje,
21. Rregullorja mbi kushtet dhe kriteret për dhënien e tokës ndërtimore në zonën ekonomike “Dubrava”për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike,
22. Statuti i komunës së Dragashit,
23. Rregullorja për mënyrën e furnizimit me ujë të fshatit Brrut.

Rregulloret e inventarizuara për kohën 2000 – 2008

1. Rregullorja mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare të komunës
2. Rregullorja për caktimin e orarit të punës nga lëmi i tregtisë,
3. Rregullorja për mirëmbajtjen e varrezave
4. Rregullorja për trashëgimin kulturore,
5. Rregullorja për rregullimin e qytetit,rrugëve e trotuareve
6. Rregullorja - procedurat për menaxhimin financiar në komun

Buxheti vjetor		Të hyrat vetanake
Buxheti i realizuar 2014	6,452,646.00	441,000.00
Buxheti aktual 2015	7,164,026.00	487,030.00
Buxheti i Projektuar 2016	6,896,598.00	400,000.00
Buxheti i Projektuar 2017	6,971,286.00	415,000.00
Buxheti i Parashikuar 2018	7,057,311.00	430,000.00

8. Prona Komun

Sa I perket prones se Komunes disponon me 13 842.16,00 ha.Nga kjo siperfaqe 36,00 ha jane ndar per qeshtje biznisore me Vendim te Kuvendit Komunal.

9. Kryetari i komunës

Salim Jenuzi – Kyetari i komunës

Antar i PDK-së, tani edhe kryetar i degës së PDK-së në Dragash. Kariera e punës: Profesor në gjimnaz, udhëheqës në NBQ Sharr - prodhim, ka ushtruar detyrën edhe si udhëheqës i shërbimit të ekonomisë dhe bujqësisë në kuvendin komunal.

Kontakti: [Tel:029/ 281-543](tel:029/281-543)

Email: salim.jenuzi@rks-gov.net;

Email: salimjenuzi@hotmail.com

10. Kuvendi i Komunës

(këtu duhet të shënohet lista e anëtarëve të kuvendit të komunës, sipas përkatësisë politike, si dhe të dhënat kryesore kontaktuese për Kryesuesin e Kuvendit të komunës)

Anëtarët e Kuvendit:

1. Shaban Shabani PDK, Kryesues
2. Ymredin Fetahu PDK, Anëtar
3. Granit Rifaj PDK,
4. Vehbi Nafezi PDK,
5. Artan Loshaj PDK,
6. Nazmie Velija PDK,
7. Arbnore Kryeziu PDK,
8. Samire Meleqi PDK,
9. Halim Shemsidini LDK,
10. Bahtjar Berisha LDK,
11. Samidin Xheladini LDK,
12. Kapllan Fetahu LDK,
13. Arjeta Skeraj LDK,
14. Shqipe Halili LDK,
15. Kaltrina Krasniqi LDK,
16. Nevzat Hamza CDU,
17. Hajrudin Hodza CDU,
18. Melisa Sola CDU,
19. Mersiha Memisi CDU,
20. Serif Aga VAKAT,
21. Velid Hadzisin VAKAT,
22. Zinaida Elmazi VAKAT,
23. Nexhat Isufi BD,
24. Ymridin Krasniqi AAK,
25. Luljete Berisha AAK,
26. Zaim Hajredini AKR,
27. Deir Jelmazi GIG

Kryesuesi i Kuvendit

Shaban Shabani

Kryesues i Kuvendit të Komunës Dragash

Tel: Shaban Shabani

Email: shaban.shabani@rks-gov.net

11. STRUKTURA ORGANIZATIVE

(këtu duhet të shënohen të gjitha drejtoritë komunale, me të dhënat kontaktuese të drejtorit dhe drejtorisë, si dhe të dhënat mbi sektorët dhe zyret e veçanta të komunës, me të dhënat kontaktuese të udhëheqësve të tyre)

<p>Drejtoria e Administratës:</p> <p>Drejtor: Avni Nebiu</p> <p>Tel: 029/281-005</p> <p>Email: avni.nebiu@ks-gov.net avninebiu@hotmail.com</p>	<p>Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik:</p> <p>Drejtor: Ahmet Batjari</p> <p>Tel:</p> <p>Email: ahmet.batjari@ks-gov.net aba.10@hotmail.com</p>
<p>Drejtoria për Mbrojtje, Shpejtim dhe Shërbime Publike</p> <p>Drejtor : Tafil Krasniqi</p> <p>Tel:029/281 266</p> <p>Email: tafil.krasniqi@ks-gov.net tafilkrasniqi@yahoo.com</p>	<p>Drejtoria e Arsimit</p> <p>Drejtor: Hajri Ramadani</p> <p>Tel:029/281-646</p> <p>Email: hajri.ramadani@ks-gov.net hajri.ramadani@hotmail.com</p>
<p>Drejtoria e Bujqësisë, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillimi Rural</p> <p>Drejtor: Bajram Hoxha</p> <p>Tel: Plotesohet nga Komuna</p> <p>Email: bajrampasa@gmail.com</p>	<p>Drejtoria për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje të Ambientit</p> <p>Drejtor: Bean Haxhiasan</p> <p>Tel: Plotesohet nga Komuna</p> <p>Email: beanadziasan@yahoo.com</p>
<p>Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport</p> <p>Drejtor: Sadri Beadini</p> <p>Tel: Plotesohet nga Komuna</p>	<p>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirqenjes Sociale</p> <p>Drejtor: Reshit Qafleshi</p> <p>Tel: Plotesohet nga Komuna</p>

Email: sadri.beadini@rks-gov.net	Email: reshitaqafleshi@rks-gov.net
----------------------------------	------------------------------------

12. Sektorët dhe Njësitë

Spektori Emergjencave	Zyra e informacionit
	<p>Udhëheqës: Avni Nebiu</p> <p>Tel: 029/281005</p> <p>Email: avni.nebiu@rks-gov.net</p>
<p>Zyra për Kumunitete</p> <p>Drejtor: Mehmet Hamza</p> <p>Tel: 029/281-729</p> <p>Email: mehmed.hamza@ks-gov.net</p>	<p>Zyra për Kthim</p> <p>Vezaip Kajkush - Zyrtar Komunal për kthim</p> <p>Tel: Plotësohet nga komuna</p> <p>Email: vkajkus@yahoo.com</p>
<p>Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi</p> <p>Kordinator: Azbi Halili</p> <p>Tel: plotësohet nga komuna</p> <p>Email: azbi.halili@rks-gov.net</p>	

1. Indeksi i komunës

Shërbimi i Zjarrëfikësve	“Njësia Punuese Dragash” e kompanisë “Hidroregjioni Jugor”
<p>Udhëheqës: Fari Piraj</p> <p>Tel: Plotësohet nga komuna</p> <p>Email: fari.piraj@rks-gov.net</p>	<p>Udhëheqës: Qakidgji Tershnjaku</p> <p>Tel: Plotësohet nga komuna</p> <p>Email: Plotësohet nga komuna</p>

Stacioni Autobusave	Stacioni i Trenit
Udhëheqës: Plotësohet nga komuna	
Tel: Plotësohet nga komuna	
Email: Plotësohet nga komuna	
“Njësia Punuese Dragash” e “EkoKompanisë”	Stacioni policor
Udhëheqës: Sali Shala	Udhëheqës: Plotësohet nga komuna
Tel: Plotësohet nga komuna	Tel: Plotësohet nga komuna
Email: Plotësohet nga komuna	Email: Plotësohet nga komuna

2. Punësim

Vlersohet se janë të punësuar rreth 3.500 punëtor. Prej tyre 870 në shërbys civil dhe dhe ndermarrje publike, nderkaq pjesa tjetër në sektorin privat. Në sektorin privat pjesa më e madhe janë në ndermarrje shërbyse (tregti, hoteleri dhe shërbime tjera). Sa i përket prodhimimit në industrinë e tekstilit janë të punësuar 320 punëtor.

3. Shënime me rëndësi

Arsimi

Numri i institucioneve shkollore në komunën e Dragashit është: 21 shkolla para fillore, 35 fillore të mesme të ulëta dhe një shkollë e mesme e lartë.

Disa fshatra kanë dy sisteme arsimore: sistem kosovar dhe sistemi paralel të mbështetur nga Serbia. Të gjitha shkollat kanë nevojë për investime përpërmirësimin e infrastrukturës dhe për materiale arsimore, si: libra, video-projektore, harta dhe pajisje tjera për shkollë në veçanti për kabinete të biologjisë, muzikës, fizikës, shkencave shoqërore dhe informatikës.

Kultura

Dragashi është i pasur me trashëgimi kulturore. Traditat dhe vlerat kulturore janë të thella në shoqëri dhe manifestohen në mënyra të ndryshme. Disa shembuj janë si: dita e Shën Gjergjit (festë pagane), kremtimet e fejesave dhe martesave. Këto ngjarje janë të rëndësishme në jetën e Dragashit dhe gjatë festave të tilla bartën veshje unike tradicionale të kësaj pjese të vendit. Dragashi gjithashtu ka tradita të pasura me muzikë, folklor, gara sportive (kuaj, mundje), këngë, lojëra, vallëzim dhe ushqim, për të përmendur vetëm disaaspekte të jetës, ku trashëgimia kulturore shfaqet në vetvete. Institucionet kryesore kulturore ndodhen në qytetin e Dragashit dhe përfshijnë: shtëpinë e kulturës dhe bibliotekën. Htepi të kultures ka në Brsan dhe Bellobrat, njeherit, Biblioteka më të vogla ka në Bresane, Brezne, Bellobrad, Brod dhe Krusheve. Janë edhe disa shoqëri kulturore-artistike në disa fshatra. Kultura tradicionale e Dragashit manifestohet gjithashtu edhe me një numër të artizanaleve kryesisht në qepje dhe qëndisje të veshjeve tradicionale dhe dekorime të ndryshme për shtëpi.

Sporti dhe Rinia

Klubet dhe asociacionet sportive në komunë përfshijnë: Klubin e futbollit 'Pllava' në Pllavë, Klubin e futbollit 'Liqeni' në Brezne, Klubin e futbollit 'Opoja' nga një pjesë e Opojës, Asociacionin e ecjes 'Guri i Zi' në Dragash, Klubi i Skijimit 'Arxhena', Klubi i skijimit 'Sharri', Klubi i mundjes 'Sharri', Shkolla e futbollit nga Gilloboçicë për talent të rinj. Komuna e Dragashit është shumë e përshtatshme për zhvillimin e sportit dimëror. Ajo mbështetë projekte të vogla të garave sportive sikurse: turnirët në futboll të vogël, garat e pehlivanëve, vrapimi i kuajve, etj.,

Shëndetësia

Në komunën e Dragashit gjendet një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, pasta janë 5 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 8 Ambulanca.

Si rezultat i kufizimeve buxhetore jo të gjitha fshatrat kane qendra shëndetësore. Megjithatë, është kryer një ushtrim i zonimit për të siguruar që të gjitha fshatrat janë të mbuluar me shërbime nga qendrat ekzistuese. Dragashi ka 14 mjeke (të gjithë meshkuj), 31 infermiere, 5 mami, 1 pediatër, 1 gjinekolog, 1 radiolog, 5 dentiste, 4 teknik dhëmbesh dhe 6 teknik laborator, 4 farmacist dhe popullsi prej 33,997 banoresh. Pra ne përputhje me politiken shëndetësore të Kosovës, Dragashi plotëson standardet e kujdesit shëndetësor të aspektit personel – pacient.

Shërbimet kryesore të cilat ofrohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare janë: shërbimi i shëndetit familjar, pediatria, gjinekologjia, shërbimi dental, emergjenca, diagnostika dhe furnizimi me barna.

Transporti

Qyteti i Dragashit është shënuar si një qendër e vogël me zonë ekonomike, e lidhur me atë të Prizrenit. Rrjetet rrugore dhe hekurudhore janë: aksi Prizren-Durrës që është pjesë e një korridorit të rëndësishëm ndërkombëtar të trafikut Serbi-Kosovë-Shqipëri, që i lidhë Merdaren, Prishtinën, Prizrenin dhe Durrësin. Dragashi lidhet me aksin dhe me Prizrenin përmes rrugës regjionale Dragash –Zhur.

Komuna e Dragashit është e lidhur me pjesën tjetër të Kosovës përmes dy rrugëve: njëra është e asfaltuar, e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me autostradën e re ndërmjet Shqipërisë

Turizmi

Pjesa me e madhe e territorit te Dragashit është pjesë e Parkut Nacional Sharri. Sharri për nga numri liqejeve, pas Bullgarisë (malit Rilla) zëvendin e dytë në Evropë (e dhepse Opojakanjë dhe Gorakanë dyliqej). bjeshkëtkëtushme. Nëtërësimund tëkenëepitetin e parkut nacional dhe mund të janë atraktive për turistët dimëror dhe veror, sidomos pjesët në fshatrat: Restelicë, Brod, Radeshë, Zaplluxhe, Liqenii Breznes, Shpella e Zgatarit, Namazgjahu, HC .Dikancë, etj. Tri shtyllat e turizmit në Dragash janë:

1. Bukuria natyrore (malet, biodiversiteti)
2. Kultura dhe trashëgimia (kultura Opojane dhe Gorane, mënyra e jetës tradicionale)
3. Mikpritja dhe kuzhina e pasur (ushqimi i prodhuar aty, mikpritja fshatare)

4. Problemet dhe Sfidat

(të paraqiten problemet kryesore në komunën përkatëse, sipas fushave përkatëse të ekonomisë, ambientit, qeverisjes, etj., Si dhe të paraqiten sfidat me të cilat ballafaqohen në realizimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve dhe përmirësimin të situatës)

